# DËSHMI ARKIVI

**A-395286**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 10 vite nga shenjtërimi i Nënë Terezës - Gazeta Dita |
| ADRESA | `https://gazetadita.al/me-gjak-une-jam-shqiptare-10-vite-nga-shenjterimi-i-nene-terezes/` |
| BURIMI | gazetadita.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 23:07:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 600 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 07:54:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b9f3c78ac5f609e9d22ff05ab357bf4c495272699196da5e17d96acbb2d1a496` |
| TEKSTI | `b93ac689539a268f813dd5c227a7a4cc2ca71fa57af440ded64ccf595faf5e51` |
| PAMJA | `08812c7f30a93c50e7fbe4d659502ee588c249f5040a29cf39b11aa023c1c161` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4fe85aaea11dce6acf0f40b487963861eedf94ff269d261464f12fad7cd2a005` |
| E MËPARSHMJA | `d702fda0178c7472b6cf38704af56c3bf865be2b59b1a303de9600ec5d5e8429` |
| RRËNJA MERKLE | `a67a75b7bf7126eb0fb24952420a691bdb5b122308595a99f34598f34e2b135c` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 47086362 |
| TRANSAKSIONI | `0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2` |
| IPFS | `QmQFAwWtE6kWQfJi44x8LJW9Bvy5W1Ae5ZmvuTTVQdpzhx` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4fe85aaea11dce6acf0f40b487963861eedf94ff269d261464f12fad7cd2a005`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ANALIZA KURIOZITETE

# 10 vite nga shenjtërimi i Nënë Terezës

Published: September 5, 2026

Shpërndaje



Mbarë bota përkujton 10 vjetorin e shenjtërimit të humanistes së shquar Nënë Tereza. “Me gjak, unë jam shqiptare. Me shtetësi, jam indiane. Me besim, unë jam një murgeshë Katolike. Sipas profesionit tim, unë i përkas botës.

Për nga zemra ime, unë i përkas plotësisht Zemrës së Jezusit”. Këto janë fjalët e thëna nga Nënë Tereza, gruaja e jashtëzakonshme dhe shenjtorja e të varfërve të të gjithë botës e cila kurrë nuk e harroi origjinën e saj.

10 vite më parë, më 5 shtator 2016, nëna e madhe e të varfërve, fituese e çmimit Nobel për Paqen, u shpall shenjtore. Papa Françesku, njohu dy mrekullitë e saj, të shërimit të të sëmurëve pas vdekjes së saj më 1997.

- Publicitet -

Murgesha ‘u lumturua’ në tetor të vitit 2003, nga Papa Gjon Pali II. Ai miratoi mrekullinë e parë pas vdekjes së saj. Një grua 30-vjeçare në Kalkuta tha se ajo u shërua nga një tumor në

stomak pas lutjeve të Nënë Terezës. Një komitet i Vatikanit tha se nuk mund të gjente asnjë shpjegim shkencor për shërimin e saj dhe e shpalli atë një mrekulli.

Në këtë ditë të shënuar, Nënë Tereza përkujtohet nga krerët më të lartë të shtetit dhe politikës.

**Kush ishte Nënë Tereza?**

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, që më vonë e ndryshoi emrin në Nënë Tereza, lindi me 1910 nga prindër shqiptarë dhe humbi jetën në Kalkutë më 5 shtator 1997. Sot bëhen 27 vite që Nënë Tereza është ndarë nga jeta. Ajo i mori mësimet e para në një shkollë në qytetin e Shkupit dhe në moshën 18 vjeçare u dorëzua murgeshë. Pasi u specializua në Irlandë u vendos në Indi, ku në vitin 1950 themeloi urdhrin e saj të murgeshave të quajtur Misionarët e Bamirësisë.

Nga ky moment Nënë Tereza do të bëhej nënë e të gjithëve dhe jetën e saj do t'ia dedikonte tërësisht të varfërve. Ajo vazhdoi me vetmohim të predikonte mesazhin e saj të dinjitetit njerëzor dhe respektit për çdo qenie njerëzore të lindur apo jo.

Kur mori çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979 ajo bëri këtë apel: "Shkatërrimtari më i madh i paqes së sotme është thirrja e një fëmije të pafajshëm ende të palindur. Nëse një nënë vret fëmijën që mban në barkun e saj, atëherë çfarë mbetet për ty dhe mua?

Nënë Tereza ndërroi jetë më 5 shtator 1997 në Kalkuta të Indisë, ku ushtroi pjesën më të madhe të aktivitetit të saj bamirës, por figura e saj vazhdon të jetë burim frymëzimi për bamirësi, besim dhe shërbim të përulur, veçanërisht në një botë gjithnjë e më të përçarë nga varfëria dhe padrejtësitë sociale. Gjatë jetës së saj, Nënë Tereza ka marrë më shumë se 700 çmime për punën e saj bamirëse.

*j.l./ dita*

**Shpërndaje këtë artikull**

Facebook

## 1 Comment

**demo**

Reply

Hypokrizine e shqiptareeve une nuk e duroj dot,.Nje popull hypokrit,lapanjoz,nga kane dale mostra me shumice si Enver Hoxha,Sali Berisha,Edi Rama.Kjo zonja Nene Tereze e Kalkutes(si thirrej ne ate kohe),ishte shume e njohur ne Bote ne vitet 70.;Aq e njohur ishte,sa kur zhvilloheshin luftime te egra ne Liban midis arabeve dhe izraeliteve,vetem ambulancat e motrave te nene Terezes mund te nderprisnin luftimet per te terhequr viktimat.Ne Shqiperi nuk njihej,asqe behej fjale per perrkatesine Ethnike.Ne Shqiperi vetem Une,qe ndiqja RAIn dhe Zerin e Amerikes e ndonje mik i familjes ne Shkoder dinim te verteten e Gonxhe Bojaxhiut.Sigurisht edhe redaksia e Rilindjes ne Prishtine.Pikerisht ne keto vite ndrrojne jete nena dhe motra e nene Terezes dhe regjimi Enverit nuk lejoi ate te vinte ti varroste.Me gjithe perpjekjet diplomatike te gjithe Botes nuk e lejuan te hidhte nje grusht dhe.Ky po0pull,qe qau me oiii,mbajti 3 dite zi per Patrik Lomumben,nje rebel marxist ne Kongo.Cfare dreqin i lidh me nene Terezen e Kalkutes?Aeroporti nene Tereza,Sheshi nene Tereza,,ma vaaaa!
Nje popull si Edi Rama,qe pasi dogji e betonoi ullishta,parqe,lulishte,pyje,laguna me Flamingo,sot jep lexione per mbjelljen e ullinjve.
Lereni te qete nene Terezen ne Kalkute e mos ja permendni fare token e hypokritave,,or popull legen!

## Leave a Reply

Posto një koment

Emri juaj

Post Comment

## Kategori

demo on **Rama reagon për zjarret në Himarë: Nis vlerësimi i dëmeve, dëmshpërblim për të prekurit**

Mutdhënësi on **Një ditë pas plumbave, Kryeministër Edi shpall ullishten e parë strategjike**

nje shqiptar on **Një ditë pas plumbave, Kryeministër Edi shpall ullishten e parë strategjike**

MAKS on **Sherri i biznesmenëve në Vlorë, Rama: Toka do shpronësohet, do kthehet në ullishte**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.